



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 28 tetor 2016, në mbledhjen e XXXIII-të (tridhjetetretë) , të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Ejup Visoka, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe Muharrem Haziri, OSBE.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e përshëndeti z. Ejup Visokën, i emëruar drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe i dëshiroi suksese në punën e mëtejme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Raporti Financiar i komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2016

z. Bahri Blakçori, theksoi, ky raport pasqyron aktivitetet financiare për periudhën nëntëmujore, sigurisht në mbledhje të Kuvendit do të diskutohet më në detaje, mirëpo jam i mendimit se është një pasqyrë reale e shpenzimeve dhe në përputhshmëri me aktivitetet e zhvilluara.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se raporti është paksa i vonuar gjithashtu nuk mund të arsyetohet mungesa e drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili do duhej të arsyetoj shpenzimet e bëra, mirëpo në mbledhje të Kuvendit gjithsesi duhet të paraqet arsyeshmërinë e shpenzimeve përkatëse.

Në mbledhje është i pranishëm z. Ejup Visoka, që sipas mendimit tim nuk mund të jep sqarime të nevojshme ngase është i porsaemëruar në pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, të cilit i uroj suksese në detyrën e cekur.

Në cilësinë e shefit të Grupit të këshilltarëve të PDK – së, duke u bazuar se në këtë mbledhje nuk mund të marrim vendim, diskutimin tim do ta paraqesë në mbledhje të Kuvendit.

z. Haki Rudari, theksoi, jemi duke debatuar për Raportin financiar për përudhën nëntëmujore, mirëpo kemi mungesë thujse të tërë Ekzekutivit ngase në mbledhje është i pranishëm vetëm drejtori z. Ejup Visoka.

Kam thënë edhe më herët se i përcjell mbledhjet edhe të Kuvendeve të komunave të tjera, mirëpo ka tri vite që Komiteti për Politikë dhe Financa po anashkalohet dhe nënçmohet nga Ekzekutivi dhe të tjerët për mospjesëmarrje në mbledhje, me përjashtim të disa drejtorëve të cilët janë të rregullt.

Në një gjendje të këtillë si mund të diskutohet në detaje kur nuk ka askush për të dhëne sqarime të shumta lidhur me shpenzimet buxhetore, ky është element që Kryetari i Komunës duhet ta ketë parasysh.

Pa u lëshuar në detaje dëshiroj të them se nga mbi 5 milion, nga kategoria e investimeve kapitale, në këtë nëntëmujor janë investuar vetëm 1.549.480 €, kjo tregon se diç nuk është mirë ose kemi mungesë të programit qeverisës që ne në vazhdimësi e kemi kërkuar.

Kudo që dalim për vizita në qytet, fshatra apo lagje, kërkesat e banorëve janë të shumta dhe meqë kërkesat e nevojat janë të shumta, shtrohet pyetja se kush është fajtor që nuk bëhen investime, fajtorë është Qeveria komunale të cilës i mungon programi qeverisës.

Krahasuar me vitin e kaluar në disa segmente kemi rritje mbi 50% shtrohet pyetja përse, a kemi kyçe më të madhe të qytetarëve apo përse është kjo përqindje kaq e lartë.

Përqindje të lartë po ashtu kemi te furnizimi me ushqim dhe pije në dy raste, pastaj nga të hyrat vetanake kemi rritje për vaj 84%, naftë për ngrohje qendrore 63%, edhe pse shkollat po kanë problem me ngrohje qendrore.

z. Kadri Avdiu, theksoi, fillimisht dëshiroj t'i shpreh mirëseardhje z. Ejup Visokës, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, i cili po merr pjesë për herë të parë në mbledhje të këtij Komiteti dhe shtoi, më vjen mirë që po përfillet obligimi për sjellën për shqyrtim të raporteve financiare periodike.

Duke u bazuar se në ndërkohë në mbledhje erdhën edhe disa drejtorë të Drejtorive, në mesin e tyre edhe z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, nëse ndokush nuk kërkon sqarime për ndonjë çështje, jam i mendimit se raporti mund t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim me mundësi që në mbledhje të Kuvendit të diskutohet më në detaje.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, shqyrtimin e Raportit financiar e filluam pa prezencën e z. Isuf Latifit, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i cili ndërkohë iu bashkëngjiti punimeve të mbledhjes dhe shtoi, në Komitetin për Politikë dhe Financa çështjet shqyrtohen në parim duke rezervuar diskutimin për mbledhje të Kuvendit, mirëpo gjatë debatit shqetësuese u paraqit shkalla e ulët e shpenzimeve të investimeve kapitale në periudhën nëntëmujore për të cilën po debatohet. Lidhur me këtë unë kam biseduar me drejtorët e Drejtorive përkatëse dhe arsyeja e kësaj vonese është ngase

në muajt e fundit bëhet pranimi teknik i punimeve dhe pagesa nuk bëhet pa u përfunduar kjo çështje, pra shumë punë janë kryer por pagesat nuk janë bërë dhe nuk kanë mundur të përfshihen në raport, mirëpo gjithsesi duhet pasë kujdes që mjetet përkatëse financiare të mos mbeten në suficit, edhe pse Komuna e Podujevës në këtë drejtim deri më tash nuk ka pasë problem.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, po i bashkëngjitem asaj çfarë tha z. Kadri Avdiu, se është krijuar rregull dhe është duke u respektuar obligimi ligjor që Raportet financiare të shqyrtohen pa vonesë në periudha tremujore, raporte në të cilat paraqitet gjendja reale e shpenzimeve dhe të hyrave për periudhat përkatëse.

Sipas këtij Raporti, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është karakteristikë se kemi zvogëlim të shpenzimeve në total dhe po ashtu kemi rritje të të hyrave vetanake në total.

Gjatë debatit dëgjova se u paraqitën vërejtje konkrete për atë se në disa kode ka rritje të shpenzimeve, mirëpo ne jemi në dijeni se shpenzimet asnjëherë nuk janë fikse, pra mund që në këtë vit të mos ketë fare shpenzime të një lloji të caktuar por vitin vijues mund të ketë rritje, ashtu siç mund të jetë që në një vit të ketë shpenzime të caktuara e vitin tjetër të ketë zbritje.

Ligji për faljen e borxheve të tatimit në pronë, tani është përmbyllur afati por sërish do të vazhdoj, në periudhën paraprake kanë përfituar mbi dy mijë obligues, kuptohet në Komunën e Podujevës, ndërsa ne i kemi mbi 20 mijë fatura prej të cilave mund lirshëm të them se 12 mijë fatura janë me borxhe, nga kjo rezulton se një pjesë e madhe e obliguesve nuk i kanë shfrytëzuar lehtësirat ligjore për faljen e borxheve, andaj në periudhën e dytë duhet sensibilizuar në mënyrë që të zvogëlohet numri i borxhlinjve të tatimit në pronë.

Pas votimit u konstatua se raporti financiar njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

3. Propozimi i Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës

- Propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, materiali për këtë pikë të rendit të ditës ju është dërguar me kohë, i njëjti është punuar në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës, përndryshe është një draft unik me komunat tjera, kuptohet me ndryshim të specifikave që i ka Komuna e jonë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam i mendimit se drejtoreshës të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit do t'i nevojitet angazhim mjaftë i madh për ta funksionalizuar Këshillin e Veprimit Rinor Lokal, këtë çështje jemi duke e trajtuar në vitin 2016 që do të thotë se jemi të vonuar ngase komunat tjera e kanë miratuar këtë Rregullore shumë vite më parë.

Ne në cilësinë e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, apo në cilësinë këshilltarëve të Kuvendit duhet të fokusohemi në atë që të propozojmë ndonjë ndryshim të propozimit të Rregullores para se ajo të vihet në diskutim publik.

Konsideroj se për propozimin e kësaj Rregulloreje diskutimi publik duhet të jetë një muaj me obligim që Drejtoria të bëjë marketing në mënyrë që për këtë çështje të informohen të gjithë të interesuarit.

z. Naim Çunaku, theksoi, në radhë të parë z. Ejup Visokës, i emëruar drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, i dëshiroj suksese në punë dhe besoj se me përvojën dhe angazhimin e tij do ta përforcoj qeverisjen komunale.

Konsideroj se në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa kemi hyrë të papërgatitur, kur them të papërgatitur në radhë të parë mendoj në atë se na mungon stafi i Ekzekutivit. Sot jemi duke debatuar për propozimin e një Rregulloreje që do duhej të sponsorizohej nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mirëpo mungon drejtoresha e asaj Drejtorie. Po e vërej se edhe ne si anëtarë të këtij Komiteti, apo si këshilltarë të Kuvendit, nuk jemi në nivelin e duhur ngase nuk po e shoh se e kemi konsultuar materialin. Unë kisha dashtë që mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të ngritën në një nivel tjetër, jo çfarë jemi duke bërë, nuk na mjafton neve të themi e debatojmë në Kuvend se fundja atëherë shtrohet pyetja përse ekziston Komiteti për Politikë dhe Financa. Këtu duhet të trajtohen temat, të pasurohen materialet, në rastin konkret do duhej ta dëgjojmë drejtoreshën për qëllimin e kësaj Rregulloreje dhe gjatë debatit të pasurohet në mënyrë që para Kuvendit të dalim me një material të përpunuar, e jo me një material i cili vetëm kalon përmes këtij Komiteti.

Pajtohem që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë një muaj, por sa i përket datës së mbajtjes të debatit publik konsideroj se për këtë do duhej të merret mendimi i drejtoreshës e cila duhet të jetë e pranishme në debatin me qytetarë për të dhënë sqarimet e nevojshme.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, parafolësi tha, në shumës, se sa i përket materialit kemi ardhur të papërgatitur në mbledhje, mirëpo ne u kyçëm në diskutime e z. Naim Çunaku u kyç i fundit.

Çështja është se Komiteti për Politikë dhe Financa nuk merr vendime dhe nuk mund ta ndërroj materialin por vetëm në kuptimin e rekomandimeve, e Kuvendi është organi vendimmarrës.

Jeni në dijeni se në vazhdimësi kam kërkuar edhe prej kryesuesit edhe prej këtij Komiteti përmbushjen e një obligimi ligjor, që është edhe obligim i Drejtorive, në mënyrë që Komiteti për Politikë dhe Financa të merr pjesë në hartimin e Planit të punës të Zyrës së prokurimit, shtohet pyetja se a keni qenë këmbëngulës që kjo çështje të shqyrtohet në këtë Komitet, në emër të të gjithëve po përgjigjem jo.

z. Naim Çunaku, theksoi, fola në parim se të gjithë jemi të papërgatitur, këtë e bazova se ne sot në këtë mbledhje e kemi një propozim të Rregullores për ta shqyrtuar, unë nuk dëgjova nga asnjë anëtar i këtij Komiteti që e paraqiti një vërejtje apo të paktën një sugjerim për këtë material dhe nga kjo nxora përfundimin se në mbledhje kemi ardhur të papërgatitur. Përndryshe nuk ka pas propozime të rregulloreve që janë shqyrtuar në këtë Komitet e që nuk janë dhënë të paktën sugjerime për ndryshime dhe plotësime konkrete.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sikur të isha në vend të kryesuesit të këtij Komiteti, për shkak të mungesës të drejtoreshës të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, unë kisha kërkuar që këto dy pika të rendit të ditës të mos procedohen në Kuvend.

z. Naim Çunaku, theksoi, parafolësi në formë të përgjithësuar tha se nuk kemi kërkuar dhe nuk kemi shprehur gatishmëri të jemi pjesë e hartimit të Planit të Zyrës së

prokurimit publik, z. Rafet Llapashtica mund të mos jetë në dijeni por anëtarët e tjerë të këtij Komiteti, si dhe ata në mandatet paraprake, janë në dijeni se është kërkuar të shqyrtohet çështja e cekur, dëshmi janë procesverbalet, mirëpo nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim.

Po e them edhe një herë, nëse vazhdojmë në këtë formë, unë shtroj pyetjen përse ekziston Komiteti për Politikë dhe Financa.

z. Fidan Rekalii, theksoi, jam i mendimit se askush nuk mund t'i thotë askujt se është apo nuk është i përgatitur për mbledhje, ne të gjithëve materiali na është dërguar me kohë dhe ndokush është përgatitur më shumë e ndokush më pak, e rëndësishme është se të gjithë u pajtuam se në mbledhje është dashtë të jetë e pranishme drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të dhënë sqarime për dy pika të rendit të ditës, mirëpo edhe kjo nuk paraqet ndonjë problem të madh ngase ajo duhet të jetë e pranishme në mbledhjen e Kuvendit ku do të paraqet arsyeshmërinë për dy materialet përkatëse.

Është shumë e qartë se ky material do të vihet në diskutim publik me këtë nënkuptohet se kemi kohë të mjaftueshme për të paraqitur propozime, plotësime dhe sugjerime.

Përndryshe obligimi i jonë si Komitet për Politikë dhe Financa është që Kuvendit t'i rekomandojmë apo të mos i rekomandojmë shqyrtimin e materialeve të ndryshme.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, jeni në dijeni se deri kohë më parë mbledhjet e këtij Komiteti kanë zgjatë nga dy orë dhe të njëjtat diskutime janë bërë edhe në mbledhje të Kuvendit, andaj jemi pajtuar të gjithë që në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të paraqiten vetëm çështjet parimore, ndërsa në mbledhje të Kuvendit të diskutohet në detaje. Unë e kam lexuar materialin dhe nuk kam ndonjë vërejtje, e kuptoj se ndokush diskutimin e tij e ruan për mbledhje të Kuvendit apo e planifikon që vërejtjet t'i paraqet gjatë diskutimit publik.

Bazuar në këtë konsideroj se nuk paraqet kurrfarë problemi që ky material t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pajtohem se është lëshim që drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk është e pranishme në mbledhje, atë pak më parë e thirra përmes telefonit dhe u befasua, mirëpo unë nuk jam në dijeni se a nuk është ftuar apo ka harruar të vijë në mbledhje.

Pas votimit u konstatua se propozimi i kësaj Rregulloreje, propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, afati i diskutimit publik të zgjatë një muaj, përkatësisht, prej 01 nëntor 2016 deri më 30 nëntor 2016, ndërsa debati me qytetarë të mbahet të mbahet më 23 nëntor 2016.

4. Propozimi i Statutit të Teatrit të Qytetit “ Avdush Hasani “ në Podujevë **- Propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik**

Kryesuesi i z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalii, theksoi, propozimin e Statutit të teatrit të qytetit “ Avdush Hasani “ , Grupi i këshilltarëve të LDK – së i rekomandon Kuvendit për shqyrtim, përkatësisht propozimin e Vendimit për vënie në diskutim publik. Ndërsa sa i përket datës së mbajtjes të debatit me qytetarë ne konsiderojmë se kjo datë duhet të caktohet në koordinim me drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ne të gjithë e kemi mbështetur Vendimin për themelimin e Teatrit të qytetit dhe Grupi i këshilltarëve të PDK – së i mbështet të gjitha veprimet për funksionalizimin e plotë të teatrit.

Sa i përket mungesës së drejtoreshës të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila ka qenë këshilltare e Kuvendit në disa mandate, nuk mjafton arsyetimi apo vërejtja për mos prezencë as për të e as për drejtorë të Drejtorive të tjera duke u bazuar se ne si institucion duhet të jemi në nivel të përgjegjësisë, nuk flasë në aspektin e opozitës ngase ne gjithherë i kemi mbështet çështjet në pajtim me dispozitat ligjore dhe në të mirë të qytetarëve.

Personalisht jam i mendimit se sikur të isha në vend të kryesuesit të këtij Komiteti, për shkak të mungesës së drejtoreshës, këto dy pika të rendit të ditës nuk i kisha proceduar për shqyrtim në Kuvend, me të vetmin qëllim që ajo të disiplinohet.

z. Haki Rudari, theksoi, unë jam i mendimit se për punët dhe angazhimet e drejtorëve të Drejtorive përgjegjësia është e Kryetarit të Komunës ngase është kompetent të përcjellë punën e Ekzekutivit në përgjithësi.

Neni 5 i propozimit të Vendimit për vënie në diskutim publik thotë “ Diskutimin publik e zbaton Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkërendim me Këshillin Drejtues të Teatrit të Qytetit “, mirëpo në këtë mbledhje mungon drejtoresha për të dhënë sqarimet e nevojshme.

Ne po vijmë në mbledhje të këtij Komiteti dhe të Kuvendit, po ashtu ditën e djeshme kemi qenë në një takim të thirrur nga kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës, takim në të cilin kam marrë pjesë por që paraprakisht me përpjekje shumë të mëdha e kam siguruar zëvendësimin e orëve mësimore në shkollën e fshatit Siboc, ku punoj.

Gjatë debatit u përmend se në mbledhje po vijmë të papërgatitur, lirshëm mund të them se materialet për mbledhjen e sotme i kam lexuar disa herë, por jo vetëm të sotmen por në asnjë mbledhje nuk shkoj i papërgatitur.

z. Kadri Avdiu, theksoi, jam i mendimit që ky propozim Kuvendit t'i rekomandohet për shqyrtim, ndërsa sa i përket datave për mbajtjen e debatit publik në konsultim me drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të vendoset në mbledhjen e Kuvendit e cila është caktuar të mbahet më 31.10.2016.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, afati i diskutimit publik të zgjatë një muaj, përkatësisht, prej 01 nëntor 2016 deri më 30 nëntor 2016, ndërsa debati me qytetarë të propozohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Mbledhja përfundoi në orën 13.50’.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-80578
Podujevë,
28 tetor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**